




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna Vushtrri
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Komisioni për përgatitjen e Draft-Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores (KKV) nr.03/2020 për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat

PROCESVERBAL / RAPORT

Bazuar në vendimin e Kuvendit të Komunës z., me numër protokoll 01-nr.83/22 për formimin e komisionit për përgatitjen e draft –rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores (KKV) nr.03/2020 për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat komisioni në përbërje nga: 1. Fatmir Feka, zyrtar Ligjor ne DEBPZHR, 2. Tefik Maloku, shef i sektorit te Bujqësisë 3. Mentor Hasani – anëtar i kuvendit, 4. Agim Bregaj-anetar i kuvendit dhe 5. Refik Maloku anëtar i kuvendit, ka hartuar draftin e kësaj rregulloreje në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12, shkronja “c” të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 qershor 2008”; neni 17, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.27 e datës 3 qershor 2018”; neni 36, paragrafi 3 i rregullores financiare Nr.01/2013 e datës 25 gusht 2013 të MF Shpenzimi i parave publike, neni 43, pika 4 dhe 6, Rregulloren e MF Nr.-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik, si dhe nenin 40, paragrafi 2, pika “a” të Statutit të komunës Pas hartimit të draftit të kësaj rregulloreje komfor Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, komisioni ka vënë në diskutim draftin e rregullores me njoftimet për konsultimet publike, të cilat janë publikuar në ueb faqen e komunës, gjithmonë duke i respektuar afatet e parapara me UA.

Me rastin e publikimit ne ueb faqen e komunës për vënien ne diskutim publik te draft-rregullores, komisioni ka vënë ne dispozicion adresën zyrtare elektronike fatmir.feka@rks-gov.net për te gjithë te interesuarit rreth draft-rregullores.

Konsultimi publik është mbajtur me date 16.05.2022 ne sallën e Kuvendit te Komunës ku kane marre pjese 22 persona.

Te gjithë te pranishmit i kane përkrah përkrahë ndryshimet ne këtë rregullore derisa Remzije Zekolli propozon qe nëse nuk ka pengesa ligjore te futet si pik përkrahja e gjinisë femërore me prioritet.

Baki Haradinaj kërkon që edhe kombajnerët në të ardhmen të përkrahen nga komuna.

Vushtrri 08.06.2022

Përpilojë: Tefik Maloku